



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



---

**KËSHILLI DREJTUES**

**RR E G U L L O R E**  
**E**  
**PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË**  
**TEATRIT TË QYTETIT TË PRISHTINËS**  
**"DODONA"**

Gusht, 2020

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c) e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.6 i Ligjit nr. 04/L- 106, për teatrot, nenit 10, paragrafi 6, pika f) e Statutit të TQP "Dodona" dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c) e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 08.01.2021, e miratoi këtë

**R R E G U L L O R E**  
**T Ë**  
**PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË**  
**TEATRIT TË QYTETIT TË PRISHTINËS**  
**"DODONA"**

**Neni I.**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1. Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Këshillit Drejtues (në tekstin e mëtejme: Këshilli);
2. Këshilli emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës dhe punën e tij e kryen në bazë të Ligjit nr. 04/L-106, për teatrot dhe Statutin e TQP "Dodona";
3. Çështjet dhe pyetjet me rëndësi nga fushëveprimi i Këshillit, shqyrtohen në takimet e Këshillit Drejtues;
4. Secili anëtar i Këshillit, në bazë të përgjegjësive të tij kolektive, duhet të respektojë ligjin në fuqi, Statutin e TQP "Dodona" dhe aktet tjera, si dhe të zbatojë vendimet e mbledhjes së përgjithshme në pajtim me ligjin.

5. Sipas legjislacionit në fuqi, fushëveprimi i Këshillit është:

- a) të mbikëqyrë punën e teatrit;
- b) të aprovojë politikat afatgjate dhe programin në zhvillimin e teatrit dhe politikën artistike;
- c) të miratojë planin vjetor buxhetor të teatrit, në bazë të propozimit të drejtorit të teatrit;
- d) të miratojë programin artistik vjetor të teatrit, në bazë të propozimit të udhëheqësit artistik dhe në përputhje me buxhetin vjetor;
- e) të shqyrtojë dhe miratojë raportin vjetor financiar dhe raportin e punës së teatrit;
- f) të hartojë dhe propozojë Statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të teatrit, të cilat i miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës;
- g) të intervistojë kandidatët dhe të zgjedhë drejtorin dhe udhëheqësin artistik të teatrit;
- h) të nisë procedurën dhe të bëjë shkarkimin e drejtorit dhe udhëheqësit artistik;
- i) të kryejë punë dhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj, statut të TQP "Dodona" dhe me vendime të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

6. Anëtarët e Këshillit i përgjigjen dhe i raportojnë Kryetarit të Komunës për punën e tyre.

8. Për realizimin e synimeve të tij, Këshilli bashkëpunon me Komunën e Prishtinës, gjegjësisht Drejtorinë e Kulturës.

## **Neni 2**

### **PËRBËRJA E KËSHILLIT DREJTUES**

1. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me të drejtë vote;
2. Mandati i anëtarit të Këshillit është 4 (katër) vjet. Anëtarët e Këshillit duhet të jenë personalitete të dëshmuara, të cilët vijnë nga fusha përkatëse;
3. Anëtarët e Këshillit i emëron dhe i shkarkon Kryetari i Komunës;
4. Njëri nga 5 anëtarët e Këshillit duhet të jetë përfaqësues i Komunës së Prishtinës;
5. Të gjithë anëtarët e Këshillit shërbejnë në cilësinë individuale në Këshill, e jo si delegatë ose përfaqësues të një interesi të veçantë grupor;
6. Për punën e tij, Këshilli i raporton në baza vjetore Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

### **Neni 3.**

#### **PËRGATITJA DHE THIRRJA E MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT DREJTUES**

1. Mbledhjet i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Këshillit;
2. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i moshuar i Këshillit;
3. Anëtarët e Këshillit do të ftohen së paku dy ditë para se të mbahet mbledhja. Ftesa dhe agjenda e propozuar dërgohen me shkrim, e-mail, apo çfarëdo forme tjetër të informimit;
4. Këshilli ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku 3 anëtarë të Këshillit;
5. Propozimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, atëherë vendos vota e kryesuesit.
6. Kryesuesi i Këshillit është i obliguar të thërrasë mbledhje, nëse këtë e kërkojnë së paku 3 anëtarë të Këshillit;
7. Mbledhjen e Këshillit mund ta kërkojë edhe drejtori i TQP "Dodona";
8. Nëse kryesuesi i Këshillit, për çfarëdo arsye, nuk e thërret mbledhjen e KD-së, atëherë Këshilli mund të mblidhet edhe nga propozuesi;
9. Anëtari i Këshillit është i obliguar që rregullisht të jetë prezent në mbledhje të Këshillit, dhe të shkëmbejë informata të rëndësishme për teatrin dhe autoritetin i cili e ka propozuar.

### **Neni 4**

#### **UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJE**

1. Para fillimit të mbledhjes, kryesuesi e verifikon kuorumin dhe më pas e propozon rendin e ditës;
2. Në mbledhje të Këshillit mund të jenë të pranishëm edhe drejtori i TQP "Dodona", e sipas nevojë edhe udhëheqësi artistik, mirëpo pa të drejtë vote;
3. Në mbledhje të Këshillit mund të ketë edhe të tjerë të pranishëm, me ftesë të kryesuesit ose me vendimin e Këshillit;
4. Në raste kur anëtarit/anëtares së Këshillit i ndalon mandati edhe para kohës në të cilën është emëruar, anëtarit të ri të Këshillit i zgjatet mandati deri në skadimin e mandatit të anëtarit/anëtares së Këshillit, me kohëzgjatje të paracaktuar;
5. Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit;

6. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës bëhet veç e veç, sipas rregullit, së pari në parim pastaj në veçanti;
7. Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryesuesi. Kryesuesi mund të propozojë që koha e shqyrtimit të zgjatë, p.sh. 5 minuta;
8. Askush nuk mund ta marrë fjalën në diskutim para se t'ia japë fjalën kryesuesi, t'i ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë të pengojë punën e mbledhjes;
9. Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, në bazë të rregullës, zgjat derisa të mbarojnë diskutimet e të gjithë anëtarëve të paraqitur për diskutim;
10. Kryesuesi mbyll diskutimin dhe kërkon të kalohet në propozime.
11. Në bazë të propozimeve në material dhe mendimeve të shprehura gjatë diskutimeve, kryesuesi formulon konkluzionet dhe ato i paraqet për votim;
12. Për propozime vendoset me votim të hapur, i cili bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim;
13. Propozimi konsiderohet i miratuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm;
14. Në raste urgjente, KD mund të sjellë vendime edhe në formë të shkruar (postë elektronike, letër postare, faks...).

## **Neni 5**

### **SHKARKIMI I DREJTORIT**

1. Këshilli e inicion procedurën dhe vendos për shkarkimin e drejtorit dhe udhëheqësit artistik, në këto raste:
  - a) Për shkelje të ligjit, të statutit dhe akteve nënligjore të institucionit dhe të akteve tjera që e rregullojnë marrëdhënien e punës, e të cilat cilësohen shkelje të rënda;
  - b) Për shkelje të vazhdueshme, të cilat nuk cilësohen si shkelje të rënda;
  - c) Për shkak të performancës jo të mirë, të dokumentuar;
  - d) Kur ekziston dyshimi i bazuar se drejtori ose udhëheqësi artistik, ka kryer vepër penale.

## **Neni 6**

### **PROCESVERBALI**

1. Për punën e Këshillit në mbledhje mbahet procesverbali;
2. Procesverbalin e mban njëri nga anëtarët e KD-së;
3. Procesverbali i mbledhjes së Këshillit përmban të dhënat themelore, siç janë: data dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes, shenja dhe numrin e mbledhjes, numrin e anëtarëve të pranishëm të Këshillit dhe të atyre që nuk janë të pranishëm, personat e tjerë që marrin pjesë, emrin e kryesuesit dhe emrin e procesmbajtësit, rendin e caktuar të ditës, emrat e paraqitësve dhe pjesëmarrësve në diskutim, me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, mendimet e ndara të anëtarëve të Këshillit dhe çështjet tjera me rëndësi;
4. Në fund të çdo pike të rendit të ditës, shënohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e paraqet kryesuesi;
5. Procesverbali hartohet në origjinal dhe në tri (3) kopje. Dy kopje dërgohen në Kuvendin e Komunës, ndërsa një kopje mbetet në TQP "Dodona".
6. Procesverbali origjinal duhet të nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga procesmbajtësi, dhe ai ruhet me materialin tjetër të mbledhjes në arkivin e teatrit dhe Kuvendin e Komunës. Në këtë mënyrë dokumentacioni adekuat do të shërbejë si referencë edhe për të ardhmen.

## **Neni 7**

### **KOMPENSIMI**

1. Kompensimi monetar për punën e Këshillit bëhet sipas Vendimit për pagesën e këshillave, Komitetit për auditim, komisioneve dhe grupeve punuese, me numër 01-031-114568, të dt. 11.07.2013, nenit 7, pikat a) dhe b), 60 € - kryesuesi, përkatësisht 50 € - anëtarët për takim.

## **Neni 8**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, rregullohen me Ligjin nr. 04/L- 106, për teatrot, dhe me Statutin e TQP "Dodona".

2. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-110/05-4436/21, më 11.01.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

